



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR
Sociolinguistikë

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare
Viti / Semestri : Viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze
Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT –së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri bazë mbi konceptet, nocionet dhe drejtimet kryesore të sociolinguistikës, përfshirë marrëdhëniet midis gjuhës dhe shoqërisë, variacionet gjuhësore dhe ndikimet sociale në gjuhë. Të zhvillojë aftësitë analitike dhe kritike të studentëve për të vlerësuar teori dhe modele kërkimore, si dhe për të zbatuar këto njohuri në analiza konkrete të dukurive gjuhësore në kontekste sociale. Të nxisë ndërgjegjësimin ndërdisiplinor dhe ndërveprimin praktik të sociolinguistikës me fusha të tjera të studimit, përmes diskutimeve, prezantimeve dhe projekteve kërkimore.

Objektivat specifike lëndore: Kursi synon që studentët

1. Të kuptojnë konceptet themelore të sociolinguistikës, të aftësohen në analizën kritike të teorisë dhe modeleve kërkimore, si dhe të zhvillojnë ndërgjegjësim për lidhjen midis gjuhës dhe shoqërisë.
2. Studentët do të përfshihen aktivisht në diskutime, do të përgatisin prezantime mbi artikuj shkencorë dhe do të mësojnë të lidhin temat e trajtuara me fusha të tjera të studimit.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit, studentët do të jenë:

1. Të aftë të identifikojnë dhe aplikojnë konceptet bazë sociolinguistike në kontekste të ndryshme, të krahasojnë qasje teorike, të analizojnë faktorët socialë që ndikojnë në variacionin gjuhësor dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në diskutime dhe prezantime akademike